

## Vendim nr. 267 datë 11.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare  
Marjana Semini, Anëtare  
Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 11.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 40 (A) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:**

**AGIM SHEHI**

**OBJEKTI:**

**Shfuqizimi i vendimeve nr. 2385 (80-2015-1026), datë 04.05.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 1668, datë 19.04.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-710, datë 08.02.2024 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe kthimi i çështjes për rishqyrtim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.**

**BAZA LIGJORE:**

**Nenet 18, pika 1, 33, 131, shkronja “f” dhe 134, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 50, pika 4 dhe 51/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 61, datë 12.02.2014 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajshme, pronë private që preken nga ndërtimi i projektit “Përmirësimi i sistemit të kanalizimit të Tiranës së Madhe”” (VKM nr. 61/2014), bazuar në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interesa publikë” (Ligji për Shpronësimet), ka shpronësuar, ndër të tjera, edhe pasurinë e kërkuarit Agim Shehi, të llojit “arë”, me sipërfaqe 9470 m<sup>2</sup> përkundrajt vlerës 4 242 560 lekë të llogaritur me 448 lekë/m<sup>2</sup>. VKM-ja nr. 61/2014 ka hyrë në fuqi menjëherë dhe është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 21, datë 03.03.2014.

2. Në datën 22.09.2014 kërkuari i është drejtuar gjykatës me padi për konstatimin e pavlefshmërisë së shpronësimit të pasurisë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 7831, datë 29.12.2014, e ka rrëzuar atë. Mbi apelin e kërkuarit, Gjykata Administrative e Apeli, me vendimin nr. 3931, datë 21.09.2017, ka vendosur prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes. Ndaj vendimit nuk është ushtruar rekurs.

3. Gjatë gjykimit të çështjes në shkallë të dytë, në datën 05.02.2015, kërkuari ka ngritur një tjetër padi në gjykatë, duke kërkuar ndryshimin e pjesshëm të VKM-së nr. 61/2014 për vlerën e shpronësimit, me pretendimin se ajo duhej përcaktuar sipas vlerës së tregut. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2385 (80-2015-1026), datë 04.05.2015, ka vendosur rrëzimin e padisë, me arsyetimin se ishte ngritur jashtë afatit ligjor 30-ditor dhe se pretendimi për vlerën e shpronësimit ishte i pabazuar, për shkak të mungesës së referencave të sakta të çmimeve të tregut.

4. Mbi bazën e apelit të kërkuarit, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1668, datë 19.04.2018, ka vendosur prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes, duke arsyetuar se padia është parashkruar dhe, për pasojë, ajo nuk mund të ngrihet. Gjykata e apelit, me të njëjtin vlerësim si gjykata e shkallës së parë, ka vënë në dukje se kërkuari kishte paraqitur në datën 22.09.2014 padinë e parë ndaj VKM-së së shpronësimit, që tregonte se ai kishte marrë dijeni efektivisht, ndaj padia e dytë e paraqitur në datën 05.02.2015 ishte dukshëm jashtë afatit ligjor 30-ditor nga marrja dijeni për vendimin e shpronësimit. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuari.

5. Në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-710, datë 08.02.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit me arsyetimin ai nuk përmbante shkaqet e parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

6. Në datën 04.09.2024 kërkuari, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual sipas objektit, i cili pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 23.09.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuarit

7. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar:

7.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi ai nuk ka marrë njoftim individual me shkrim për shpronësimin, siç parashikon Ligji për Shpronësimet. Padia për ndryshimin e pjesëshëm të VKM-së nr. 61/2014 është paraqitur në vazhdim të padisë së ngritur më herët prej tij për konstatimin e pavlefshmërisë së aktit, ndaj ai e ka realizuar të drejtën brenda afateve ligjore dhe në mënyrë të pandërprerë.

7.2. *Të drejtën e pronës*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi konkluzioni i gjykatave se padia e tij ishte parashkuar, i ka shkelur të drejtën e shpërblimit të drejtë nga shpronësimi.

## III

### Vlerësimi i Kolegjit

#### A. Për legjitimitetin e kërkuarit

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e

mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Në çështjen konkrete, Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ku janë dhënë vendimet e kundërshtuara, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, pasi procesi gjyqësor është përmbyllur në Gjykatën e Lartë, ndaj ai nuk ka mjete të tjera juridike në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

11. Për sa i takon legjitimitet *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata ka pohuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, kërkuesi ka pretenduar se ankimi kushtetues individual i dërguar në datën 04.09.2024 respekton afatin ligjor 4-mujor, pasi ai ka marrë njoftim për të në datën 04.07.2024. Për të provuar këtë pretendim, ai ka paraqitur një kopje të vendimit të Gjykatës së Lartë, në të cilin është vënë shënimi “U tërhoq në datën 04.07.2024”. Sipas kërkuesit, ndonëse është interesuar vazhdimisht për fatin e çështjes së tij, atij nuk i është komunikuar zyrtarisht vendimi. Ndërsa vetë Gjykata e Lartë ka informuar se vendimi është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 04.03.2024.

13. Për sa më lart, Kolegji, bazuar në standardet kushtetuese, çmon se momenti i konstatimit të cenimit të të drejtave kushtetuese të kërkuesit, nga i cili ka filluar afati ligjor 4-mujor, konsiderohet data 04.03.2024, kur vendimi i arsyetuar është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë dhe është bërë i disponueshëm për palët. Vetëm paraqitja e vendimit gjyqësor me shënimin për datën se kur është tërhequr akti nuk provon datën e marrjes dijeni efektivisht të kërkuesit, pasi një shënim i tillë mund të vendoset në çdo kohë dhe me kërkesë të kujtqo që paraqitet në Gjykatën

e Lartë. Nga ana tjetër, nuk rezulton që kërkuesi të ketë vënë në dispozicion ndonjë adresë elektronike ose të ketë kërkuar nga Gjykata e Lartë komunikimin e akteve në rrugë elektronike. Për më tepër, Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje nga vetë kërkuesi, i cili ka pasur interes për të ndjekur fatin e çështjes dhe për t'u informuar në kohë për ecurinë e shqyrtimit të rekursit të tij. Në këto rrethana, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor, konkretisht pas 6 muajve nga dita që vendimi ishte i bërë i disponueshëm për të, ndaj kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis*.

14. Për më tepër, Kolegji konstaton se pretendimet e kërkuesit nuk përmbushin as kriterin *ratione materiae*, pasi kanë të bëjnë me vlerësimin e provave dhe interpretimin e ligjit, që është detyrë e gjykatave të zakonshme, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, Kolegji vëren se gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar se padia ishte paraqitur nga kërkuesi jashtë afatit ligjor, duke analizuar faktin që ai kishte paraqitur më parë një padi tjetër ndaj VKM-së së shpronësimit të pasurisë së tij, gjë e cila provonte dijeninë efektive të tij, arsyetim i cili nuk përmban gabime faktike ose ligjore, ndaj nuk mund të konsiderohet i paarsyeshëm. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuesit, janë haptazi të pabazuara.

15. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “ç” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.